

and Daughter Found Killed along Suhareka-Prishtina Road, newsletter, KIC, 24.08.1998, FDH- 29504.

Haxhi (Qazim) Përteshi

(16.01.1941, shqiptar nga Duhla/Dulje, komuna e Suharekës/Suva Reka, bujk, 11 fëmijë)

Haxhiun e ka rrëmbyer më **10.06.1998** nga shtëpia e tij [**Duhël/Dulje**] një grup i shqiptarëve të maskuar, në mesin e të cilëve ka qenë edhe një pjesëtar i UÇK-së [identiteti i tij është i njohur për FDH]. Disa ditë më vonë, vendasit e kanë gjetur trupin e tij të pajetë në afërsi të shtëpisë së Haradin Rrafshit, në afërsi të udhëkryqit për Malishevë/Mališevo, Prishtinë/Prishtina dhe Suharekë/Suva Reka. Haxhiun e kanë varrosur më 15.06.1998 në varrezat e *Mëhallës Sopa*, në fshatin Duhël/Dulje.

Burimet: deklarata A.P, FDH-40587; J. Osmani, *Krimet...*, II, 349.

Ismet (Pljak) Beriša

(18.02.1972, rom nga Suhareka/Suva Reka, bujk, dy fëmijë)

Ismeti me familje jetonin në **Suharekë/Suva Reka**, në Rugën e *Vidovdanit* numër 19. Në datën **12.06.1998**, pjesëtarë të UÇK-së e kanë marrë nga shtëpia dhe e kanë çuar në drejtim të panjohur. Shtatë ditë më vonë, më 19.06.1998, trupin e tij të masakruar e kanë gjetur në fshatin Topliçan/Topličane, pranë rrugës Suharekë/Suva Reka – Prizren. E kishin qëlluar me afro 30 plumbash, i kishite sytë e lidhur dhe të prerat e shumta nëpër trup.

Burimet: deklarata Sh.A, FDH-32541; deklarata I.B, FDH-13449; deklarata O.B, FDH-13450; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 66, 924; AIS, *Zona...*, 56, FDH-16913; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; *Dnevnik od 17. do 23. juna*, Ilustrovana politika, num.2058, FDH-18837; *Teroristi mučili i ubili 67 nedužnih civila*, Politika, 14.9.1998, <http://www.arhiva.srbija.sr.gov.yu/vesti/1998-09/17/5250.html>.

Stojan (Mitar) Milošević

(1.08.1952, serb nga Shtërpeca/Štrpce, kuzhinier, dy fëmijë)

Stojani punonte si shërbyes civil në UJ. Ka qenë kuzhinier. Jetonte në bashkësi familjare me bashkëshorten Dobrilen, djalin Sašen dhe vajzen Natašen, në afërsi të ambulancës në Shtërpçë/Štrpce. Në datën **14.06.1998**, Stojani ka qenë në përbërje të autokolonës së UJ-së, e cila i transportonte ushqimet. Përderisa po kalonin nëpër **Duhël/Dulje** nga ora 13:00, forcat e UÇK-së shtënë ndaj autokolonës. Stojani dhe dy ushtarë i plagosën, por vetëm plagët e Stojanit ishin të rënda. E transferuan në AMU në Beograd. Atje, ka ndërruar jetë një muaj më vonë [13.07.1998] nga plagët vdekjeprurëse. E kanë varrosur në varrezat e kishës Jovani i Shenjtë në Shtërpçë/Štrpce.

Burimet: SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 44; deklarata A.G, FDH-38693; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; SMIP, *Teroristički...*, III, 717, 978; *Dnevnik od 9. do 16. juna*, Ilustrovana politika, 20.06.1998, FDH-30378; *Ubijeno pet Albanaca, ranjena četiri vojnika i jedan civil*, Naša borba 16.06.1998, http://www.yurope.com/nasa-borba/arhiva/Jun98/1606/1606_10.HTM.

Imer (Ramë) Krasniqi

(24.04.1957, shqiptar nga Caralluka/Crni Lug, komuna e Malishevës/Mališevo, murator, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Imeri u inkuadrua në UÇK në fund të vitit 1997. Ka rënë në betejë me forcat serbe në afërsi të **Bllacës/Blace**, më **16.06.1998**. E kanë varrosur një ditë më vonë në fshatin e lindjes. Pas përfundimit të luftës, më 16.06.2000, mbetjet mortore të Imerit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Malishevë/Mališevo.

Burimet: deklarata S.H, FDH-36840; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; SHFDUÇK, *Feniksët...*, 3, 63-66; *Serb Soldiers Kill Albanian at Carallukë Village of Malisheva*, newsletter, KIC, 17.06.1998, FDH-29323.

Zoran (Dragan) Anđelković

(7.03.1978, serb nga Staņcevcı, komuna e Vranjës, i pamartuar, pjesëtar i UJ-së)

Në muajin mars të vitit 1998, Zorani ka shkuar në kryerjen e shërbimit të rregullt ushtarak në Vršac. Pas tre muajsh, e risi-